

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE
për klasën I

Shkup, 2021

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	I (e parë)
Tema/fusha programore	1. Të dëgjuarit dhe të folurit 2. Shkrim-leximi fillestar 3. Letërsi, të shprehurit dhe krijimtaria 4. Shkrim-leximi mediatik dhe kultura mediatike
Numri i orëve	5 orë në javë / 180 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • tabelë, kompjuter; • material ndihmës për zhvillimin e aftësive manuale, shqisore dhe njohëse: figura dhe objekte ndihmëse (të plota dhe të çmontuara) me forma gjeometrike dhe forma të tjera që kanë të bëjnë me format e shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe dhe të disa shenjave të pikësimit; • shkopinj elastikë ("gjarpërinj") për të krijuar forma dy-dimensionale të rregullta dhe të parregullta; • argjilë, plastelina dhe mjetet për modelimin e tyre në forma të ndryshme tre-dimensionale; • allçi (gjips), ujë, ngjyra ekologjike dhe kallëpe në madhësi të ndryshme për të bërë modele të shkronjave, fjalëve, shenjave të pikësimit dhe formave të tjera; • pllaka/kuti rëre për të vizatuar dhe për të shkruar; • pëlhurë të bardhë dhe llambë ndriçuese, pëlhura shumëngjyrëshe, stofa të ndryshëm, fije peri, fije leshi dhe materiale të tjera për kukulla, marioneta, kostume dhe rekuizita të ndryshme për aktivitete teatrale, siç janë teatri i kukullave, teatri i hijeve, shfaqje dramatike dhe të ngjajshme; • fjeta pune, pllakate, ilustrime me fotografi të njerëzve nga mjediset ose profesione të ndryshme, ilustrime me fotografi të objekteve, qenieve dhe fenomeneve; • komplete tematike me fotografi të ndara ose seri fotografishë; • libra me ilustrime dhe libra të tjerë (me tregime, fabula, përralla, vjersha, dramatizime, gjëegjëza, fjalëshpejta, numërore);

	<ul style="list-style-type: none"> • revista dhe enciklopedi të ilustruara për fëmijë ; • filma të animuar, regjistrime audio-vizuale të shfaqjeve teatrale, softuerë arsimorë nga internet si dhe mjete audio-vizuale dhe mjete të tjera në varësi të qëllimit (p.sh: këngë të ndryshme shkronjash, libra digjitalë me ilustrime, etj.
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Punën edukativo-arsimore për klasën e parë mund ta bëjë mësuesi që ka kryer:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakultetin Pedagogjik - profesor për edukim parashkollor; VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS • Fakultetin Pedagogjik - profesor i mësimit klasor; VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS • Fakulteti Filozofik - Instituti pedagogjik, pedagog i diplomuar VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS

LIDHËSHMËRIA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënësve në këtë program mësimor shpesh në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën e **Shkrim-leximit gjuhësor**.

<i>Nxënësi/ nxënësjat di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i përcjellë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe pikëpamjet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e tyre amtare, përmes mediave të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme
I-A.4	të përdorë gjuhën e standardizuar, duke respektuar rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore në shprehjen gojore dhe të shkruar,
I-A.6	të identifikojë tiparet themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet, etj.) dhe ngjashmëritë dhe dallimet me gjuhët e tjera,
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve audio: të jetë në gjendje të veçojë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë informacionin nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e tij/saj
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e tij/saj,
I-A.12	të përdorë informacionet nga burime dhe media të ndryshme dhe t'i qasen në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacionit të paraqitur.
<i>Nxënësi /nxënësjat kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	përmes mësimin të gjuhës amtare zhvillohet kultura dhe identiteti kombëtar, ndërsa përmes komunikimit gjuhësor përcjellët trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit

I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste dhe mjedise të ndryshme dhe forma të ndryshme, mundësohet komunikimi dhe bashkëveprim më efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me cilin realizohet komunikimi
I-B.4	përmbajtjen dhe mënyrën e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuo për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e komunikimit,por edhe mund të shkaktojnë keqkuptime dhe konflikte.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat përkatëse nga fushat e mëposhtme të Standardeve nacionale si: **Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Kultura shoqërore dhe demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura**

<i>Nxënësi /nxënësjë din dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe si për të zgjidhur një detyrë/problem nevojitet përdorimi efektiv dhe efikas i TIK,
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet të gjejë, përzgjedh dhe shkarkon të dhëna digjitale, informatat dhe përmbajtjet,
V-A.6	të vendosë qëllime për mësim dhe vetë-zhvillim dhe të punoj për të tejkaluar sfidat që dalin gjatë arritjes së tyre,
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale që ta lehtësojë mësimnxënien dhe ta përshtat sjelljen individuale në të ardhmen,
V-A.10	të zbatojë parimet etike në vlerësimin e së drejtës dhe të gabuarës në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të shfaqë tipare të karakterit (të tilla si ndershmëria, drejtësia, respekt, durim, kujdes, mirësjellje, mirënjohje, vendosmëri, guximi dhe vetëdisiplinimi),
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe për t'u prezantuar në mënyrë të përshtatshme me situatën,
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagoj në mënyrë të përshtatshme, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e tyre në mënyrë konstruktive
V-A.15	të bashkëpunojë me tjerët në realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet individuale dhe nevojat me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve,
V-A.17	të kërkojë informatë kthyesë dhe përkrahje për vetveten, por edhe të jep informatë kthyesë konstruktive dhe përkrahje në dobi të të tjerëve,
V-A.19	të jep propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i shqyrtojë pasojat me qëllim që të realizoj konkluzat dhe të sjell vendime racionale,
VI-A.3	t'i formuloj dhe argumentoj pikëpamjet e veta, për të dëgjuar dhe analizuar pikëpamjet e të tjerëve dhe për t'i trajtuar ata me respekt edhe atëherë kur nuk pajtohet me ata,
VI-A.5	t'i kuptoj dallimet ndërmjet njerëzve në çfarëdo qoftë baze (gjinore dhe përkatësisë etnike, moshës, aftësive, statusit social, etj.) ,
VI-A.6	të dallojë praninë e stereotipeve dhe paragjyqimeve të vetja dhe të tjerët dhe të kundërshtohet në diskriminim,
VI-A.7	të njoh shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin e tyre, të vështrojnë pasojat e dhunës dhe ta kundërshtojnë atë,
VIII-A.1	të manifestojë njohuri të formave të ndryshme të shprehjes artistike nga të gjitha fushat e kulturës (letërsisë, muzikës, arteve vizuale, arteve skenike, arteve dekorative, arkitekturës, dizajnit),

VIII-A.3	të shpreh idetë, përvojat dhe emocionet e tyre duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive),
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në produktet artistike të krijuara nga të tjerët që i përkasin kulturave të tyre ose kulturave të tjera,
VIII-A.5	të shfaq njohuri për kulturën e tyre dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj përmes letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtesave dhe produkteve të tjera kulturore,
<i>Nxënësi /nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim - leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme - lehtëson të mësuarit, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim,
V-B.3	arritjet dhe mirëqenien në masë të madhe varen nga puna që ai/ajo investon dhe nga rezultatet që arrin,
V-B.4	çdo veprim që ai ndërmerr ka pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/saj,
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme,
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/saj personale,
V-B.9	kërkimi i informatave kthyesë dhe pranimi i kritikës konstruktive çon në përparim të planit individual dhe social,

REZULTATET E TË NXËNIT

<p>Fusha programore: TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT</p> <p>Orët totale:</p>
<p>Rezultatet e të nxënit:</p> <p>Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. zhvillojë bisedë të shkurtër me të tjerët 2. rrëfejë dhe të ritregojë tekste të dëgjuara, duke përdorur lloje të ndryshme fjalish 3. përshkruajë atë që ka parë në një situatë të dhënë 4. përdorë komunikim jo verbal të përshtatshëm për situatën e dhënë

Përmbajtjet (dhe nocionet):	Standardet për vlerësim:
<ul style="list-style-type: none"> • Të përshëndeturit, të prezentuarit dhe mënyra si u drejtohem i të tjerëve (mirëmëngjesi, mirëdita, mirëmbrëma, përshëndetje, tungjatjeta, mirupafshim, ditën e mirë, natën e mirë, unë jam..., faleminderit, urdhëroni, më fal, të lutem) • Zhvillimi i një bisede të shkurtër (bisedë, pyetje, përgjigje, fjali) 	<ul style="list-style-type: none"> • Prezenton veten (emrin dhe mbiemrin, çfarë dëshiron/çfarë nuk dëshiron të bëjë). • Fillon bisedën me përshëndetje dhe drejtohet me fjalë (formale dhe joformale) • Përdor me mirësjellje shprehjet e duhura në fjali (faleminderit, urdhëroni, më falni, ju lutem). • Parashtron pyetje me fjali të plota. • Përgjigjet në pyetje me fjali të plota. • Merr pjesë në diskutime për tema me interes për të (për shkollën, për familjen, për shtëpinë, për shokët, për kohën e lirë, për lojra).
<ul style="list-style-type: none"> • Shqiptimi i tingujve (tingulli) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipton saktë tinguj të ndryshëm në pozicione të ndryshme të fjalëve.
<ul style="list-style-type: none"> • Grupimi i fjalëve (fjalë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton sende, krijesa dhe bimë duke i grupuar ato sipas cilësive konkrete dhe i shënon me nocione të përgjithshme.
<ul style="list-style-type: none"> • Dëgjimi i teksteve të shkurtra dhe të thjeshta (përrallë, reklamë, njoftim, film të shkurtër/film të animuar) 	<ul style="list-style-type: none"> • Përgjigjet në pyetjet që kanë lidhje me përmbajtjen e dëgjuar. • Shpjegon (përmbledh) përmbajtjen e tekstit të dëgjuar në një ose dy fjali. • Identifikon fjalët e panjohura ose më pak të njohura nga teksti i dëgjuar. • Përdor fjalë të reja të posamësuar në fjalitë që formulon vetë.
<ul style="list-style-type: none"> • Ritregimi, rrëfimi dhe përshkrimi. (ritregon, rrëfen, përshkruan, fjali pyetëse, fjali pohore, fjali mohore) 	<ul style="list-style-type: none"> • Ritregon tekste të shkurtra dhe të thjeshta që dëgjohen dhe lexohen në orët mësimore. • Rrëfen tregim të shkurtër bazuar në seri fotografish apo ilustrimesh. • Tregon përjetimet e veta. • Përdor fjali të ndryshme gjatë rrëfimit dhe ritregimit. • Përshkruan në bazë të vëzhgimit (njerëz, sende, bimë dhe kafshë nga rrethi shkollor ose familjar si dhe qenie imagjinare).
<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi verbal 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh të folurit të shpejtë dhe të ngadaltë, gjegjësisht me zë të lartë dhe me zë të qetë.

<p>(qetë-me zë, i shpejtë-i ngadaltë, ritëm mesatar i të folurit dhe vëllimi (forca) i zërit)</p> <p>• Komunikimi joverbal</p> <p>(gjeste, mimika, lëvizje)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zbaton shpejtësinë dhe lartësinë e duhur të zërit gjatë të folurit në situata ndryshme. • Njeh kuptimet e gjesteve të ndryshme, e shprehjeve dhe e lëvizjeve të ndryshme. • Bën dallimin midis gjesteve dhe lëvizjeve të përshtatshme dhe të papërshtatshme gjatë të shprehurit. • Përdor gjestet dhe shprehjet e fytyrës për të plotësuar/zëvendësuar shprehjet verbale.
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi organizon lojë për njohjen e njëri-tjetrit: nxënësit prezentojnë veten, duke treguar emrin dhe mbiemrin, adresën dhe vendin e banimit. • Nxënësit qëndrojnë në rreth njëri pas tjetri, tregojnë emrin dhe mbiemrin e tyre dhe tregojnë nga një fjali për atë se çfarë mund të bëjnë më shumë se të tjerët (p.sh. unë mund të ngjitem në një dru, unë mund të kërcej në litar etj). Pasi që të gjithë të jenë prezentuar, vazhdohet edhe me një rreth tjetër njoftimi, duke treguar emrin dhe një fjali që tregojn se çfarë nuk mund ta bëjnë por dëshirojnë ta bëjnë (p.sh. të fluturojë me raketë, të vozisë kamion, të gatuj byrek, etj). • Nxënësit luajnë role në situata të ndryshme (në klasë, në autobus, në kuzhinën e shkollës, në bibliotekë në shitore), gjatë së cilëve situata ata ushtrojnë/praktikojnë mënyrën se si përshëndeten, si të kërkojnë falje, si të faleminderohen, si të shprehin lutje, etj. • Nxënësit bisedojnë në çifte për familjen e tyre gjatë së cilës parashtrojnë dhe i'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me numrin e anëtarëve të familjes, farefisit, shoqërisë dhe emrave të tyre. • Nxënësit bisedojnë në çifte për aktivitete të tyre gjatë kohës së lirë. • Mësimdhënësi lexon një dialog. Nxënësit kanë në duar kartelat me shenja të pikësimit: pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditje të cilat i ngrenë në përputhje me fjalën e dëgjuar. • Nga "çanta magjike" mësimdhënësi nxjerr ilustrim, lodër ose ndonjë objekt emri i të cilit fillojnë, mbaron ose përmban një tingull përkatës (p.sh. <i>b, d, sh, t, k</i>, etj.) ndërsa nxënësit thonë fjalën e duhur duke përsëritur disa herë. Pastaj mësimdhënësi thekson shqiptimin e tingullit kryesor në fjalë dhe nxënësit e shqiptojnë disa herë vetëm tingullin përkatës e më pas të gjithë fjalën. • Nxënësit në çifte të ndara tregojnë fjalëshpejta dhe në mënyrë të ndërsjellë i përsërisin derisa i mësojnë. • Nga një komplet kartelash me ilustrime të frutave, kafshëve, lodrave, sendeve të higjienës personale dhe/ose mjeteve shkollore, çdo nxënës tërheq një të tillë. Pas kontrollimit të kartelave të tërhequra, nxënësit grupohen sipas karakteristikave të përbashkëta të ilustrimeve, i paraqesin ilustrimet që përbëjnë grupin dhe sqarojnë pse janë grupuar në një mënyrë të tillë. Është një alternative që pas tërheqjes së kartelave mësimdhënësi të emërtojë kategoritë njëra pas tjetrës e të gjithë nxënësit e asaj kategorije ngrihen dhe emërojnë atë që kanë në ilustrimet e "tyre". • Nxënësit në grupe të vogla, paraprakisht ndajnë mes vete kartela që ilustronë emocione (hidhërim gëzim, dhimbje frikë dashuri etj.), i identifikojnë emocionet, imitojnë shprehjet e fytyrës dhe flasin për situatat kur kanë përjetuar emocione të tilla. 	

- Nxënësit në mënyrë individuale shfletojnë ilustrime. Mësimdhënësi lexon një fragment të zgjedhur nga libri me ilustrime dhe nxënësit identifikojnë fjalët e panjohura ose më pak të njohura. Mësimdhënësi sqaron domethënien e fjalëve ndërkohë që nxënësit krijojnë fjali të reja me fjalë të sapo mësuara.
- Mësimdhënësi përdor një videoklip të shkurtër për parashikimin e motit ose një njoftimin të emisionit për fëmijë. Nxënësit përsërisin atë që kanë dëgjuar, duke e imituar se si shprehet prezantuesi dhe i'u përgjinen pyetjeve për të parë se sa e kanë kuptuar përmbajtjen.
- Mësimdhënësi paraqet një film të animuar në gjuhë shqipe dhe pastaj kërkon nga nxënësit, në grupe të bisedojnë për përmbajtjen e filmit, ndërsa një nxënës nga secili grup përmbledh me dy-tri fjalë atë që kanë kuptuar nga filmi i animuar.
- Mësimdhënësi lexon një tekst të shkurtër, nxënësit dëgjojnë dhe pastaj me fjalët e tyre shpjegojnë përmbajtjen e dëgjuar.
- Mësimdhënësi lexon pjesë-pjesë një libër me ilustrime dhe pas çdo ndalese parashtron pyetje për përmbajtjen lexuar për të cilën përgjigjen nxënësit. Pas leximit të tërësishëm, nxënësit vazhdojnë të ritregojnë atë që kanë mbajtur mend (me nënpyetje të parashtruara nga mësimdhënësi).
- Nxënësit rrëfejnë tregime përmes një varg fotografish.
- Nxënësit tregojnë përvojat e tyre interesante.
- Nxënësit luajnë lojën "Gjueti objektësh". Kërkojnë objektin e fshehur në klasë dhe pasi ta gjejnë atë e përshkruajnë me fjalët e tyre.
- Nxënësit individualisht zgjedhin nga një objekt në klasë, e përshkruajnë të njejtin dhe tregojnë vendndodhjen e tij duke përdorur fjalët: *në, prapa, nën, mbi, majtas, djathtas ...*
- Mësimdhënësi organizon shëtitje dhe vëzhgim në mjedisin e afërt me një qëllim të caktuar (shembull: pranverë, vjeshtë, dimër, në park), pas së cilës nxënësit përshkruajnë çfarë kanë parë.
- Mësimdhënësi paraqet një zë të regjistruar me bisedë të qetë (ose vetë lexon një tekst të shkurtër duke ndryshuar vëllimin e zërit) ndërsa nxënësit njohin nëse ai fliste shpejt apo ngadalë, me zë të lartë ose të qetë.
- Nxënësit përmes simulimit apo lojërave të simuluar praktikojnë fjalime me mirësjellje dhe me një ton të arsyshëm të zërit (për shembull: në shitore apo në vende të ndryshme publike).
- Nxënësit të ndarë në grupe, identifikojnë gjeje dhe shprehje të ndryshme të fytyrës që përdoren në situata të përditshme dhe më pas bëjnë dallimin midis atyre që janë ofendues (p.sh., nxjerrja e gjuhës) dhe ata që tregojnë mbështetje (p.sh., gishtin e madh lart)
- Mësimdhënësi ndërton një hapësirë të vogël me karrige dhe thotë: "Imagjinoni që jam prapa një muri prej qelqi ku nuk dëgjohet asnjë zë. Ju doni të më thoni se këtu ka diçka që kundërmon erë të keqe, por unë nuk mund t'ju dëgjoj. Si mund ta di unë atë që ju dëshironi të më thoni?". Fëmijët së pari thonë mënyrën dhe më pas bëjnë lëvizjet adekuate, në vend që të përdorin fjalë.

Fusha programore: **SHKRIM-LEXIMI FILLESTAR**

Orët totale:

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. lexojë fjalë, fjali dhe tekste të shkurtra me kuptim,

2. shkruajë fjalë dhe fjali të shkurtra.	
Përmbajtjet (dhe nocionet):	Standardet për vlerësim:
<ul style="list-style-type: none"> • Lexim fillestar - 1 (shkronjë, tingull, fjalë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh (lexon) fjalë sipas ilustrimit të dhënë. • Njeh shkronjen e re në përbërje të fjalës/fjalisë. • I njeh simbolet e tingujve dhe i lidh me fjalë (nocionin për shkronjën). • Njeh shkronjën e re. • Ndërlidh shkronjën me tingullin përkatës.
<ul style="list-style-type: none"> • Shkrimi fillestar (shkronja shtypi, shkronja të vogla, shkronja të mëdha, pikë, pikëpyetje, pikëçuditëse, alfabet) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shkruan vija që paraqesin elemente të shkronjave. • Shkruan shkronja shtypi (të mëdha dhe të vogla). • Shkruan fjalë të thjeshta. • Shkruan fjali të shkurtra duke shfrytëzuar shkronja të mëdha dhe shenja të pikësimit (pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditje).
<ul style="list-style-type: none"> • Lexim fillestar - 2 	<ul style="list-style-type: none"> • Lexon fjalë, fjali, tekste të shkruara me shkronjat e mësuara. • Përgjigjet në pyetje të thjeshta lidhur me tekstin e lexuar. • Parashtron pyetje lidhur me tekstin e lexuar.
Shembuj të aktiviteteve:	
<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit “lexojnë” (njohin) amabalazhet e prodhimeve të ndryshme (të qumështit, të ujit, të çokollatës, etiketa me emra personal e të ngjashme), mbishkrime reklamuese, emrin e tij dhe fjalë që më së shpeshti i has në jetën e përditshme. • Nxënësit në grupe, me radhitjen e kartelave ku ka të shënuara fjalë të ndryshme (një fjalë në një kartelë), formojnë fjali. • Nxënësit luajnë lojë në të cilën ata radhiten dhe grupohen, p.sh. sipas shkronjës së parë të emrit të tyre, sipas shkronjes së parë të mbiemrit, sipas shkronjës së parë të ushqimit të tyre të preferuar, sipas shkronjës së parë të kafshës së tyre të preferuar, e kështu me radhë dhe e shënojnë grupin sipas shkronjës së shkruar në kartelë. • Nxënësit me ndihmën e plastelinës ose me shkopinj elastik (“gjarpërinj”) përpunojnë shkronjat që i përmban emri i tyre dhe “shkruajnë emrin”. • Nxënësit në hapësira të lira shkruajnë vija që përmbajnë elemente të shkronjave. • Nxënësit shkruajnë vija dhe shkronja në fletore. • Nxënësit përdorin tablet/kompjuter për të shkruar shkronja. • Nxënësit lidhin fjalët me ilustrimet e dhëna të objekteve, të kafshëve, të bimëve. 	

- Pas demonstrimit nga mësimdhënësi, nxënësit (në grupe të vogla), formojnë fjalë nga kartelat/kubet në të cilat janë të shënuara shkronjat. Fjalët e formuara, nxënësit në mënyrë të pavarur, i shënojnë në fletore.
- Nxënësit përshkruajnë fjali, nga fletët e punës ose nga tabela, të formuara me shkronjat tanimë të mësuara.
- Mësimdhënësi dikton fjali të shkurtra të formuara me shkronjat e mësuara më parë.
- Nxënësit zgjidhin fjalëkryq, në të cilin kërkesat e zgjidhjes parashtrihen përmes ilustrimeve, ndërsa plotësohen me shkrimin e fjalëve të thjeshta.
- Nxënësi emërton prodhimet nga tregu, i grupon prodhimet e emërtuara (p.sh. pemët dhe perimet). Shkruan një listë me prodhime që duhet blerë në treg.
- Nxënësit përdorin kartela me shenja të pikësimit, me pikë, me pikëpyetje dhe me pikëçuditëse që ta gjejnë se çfarë fjalie është ajo që lexon mësimdhënësi. Të njejtat fjali pastaj mësimdhënësi ua dikton nxënësve që t'i shkruajnë në fletore duke përdorur shenjat përkatëse.
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur tekst të shkurtër dhe u përgjigjen pyetjeve lidhur më të.
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur tekst të shkurtër dhe parashtrojnë pyetje lidhur më të.

Fusha programore: **LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA**

Orët totale:

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. ritregojë me fjalët e tij/saj tekst letrar të shkurtër që ka dëgjuar
2. lexojë tekst të shkurtër letrar me kuptim
3. përpunojë tekst të shkurtër letrar përmes pesonazheve, kronologjisë së ngjarjeve, vendin dhe kohën e zhvillimit të ngjarjes
4. krijojë përfundimin e tregimit ose të krijojë një tregim nga një ngjarje e caktuar

Përmbajtjet (dhe nocionet):

- **Teksti/krijimi letrar**
(tregime popullore, rrëfenja, fabula, përralla, tekste dramatike, vjersha)

Standardet për vlerësim:

- Identifikon tregimin popullore, rrëfenjën, fabulën, përrallën, tekstin dramatike, vjershën, pas dëgjimit të tyre
- Ritregon përmbajtjen e tekstit të shkurtër letrar të dëgjuar më parë, përmes pyetjeve të parashtruara
- Ritregon përmbajtjen e tekstit të shkurtër letrar të lexuar më parë, me fjalët e veta
- Njih dhe ndan fjalët që rimohen në një vjershë
- Riprodhon vjersha.

<ul style="list-style-type: none"> • Radhitja (kronologjia) e ngjarjeve në teks 	<ul style="list-style-type: none"> • Njih filimin, pjesën kyesore dhe pjesën përfundimtare të një teksti letrar • Ritregon tekst të shkurtër letrar, duke respektuar radhitjen e ngjarjeve në të • Përshkruan ngjarjen sipas ilustrimeve të dhëna • Sajon përfundimin e një teksti të papërfunduar • Sajon një përfundim ndryshe të një teksti të lexuar letrar
<ul style="list-style-type: none"> • Personazhi, vendi dhe koha në tekst 	<ul style="list-style-type: none"> • Përcakton vendin dhe kohën e ngjarjes në tekstin letrar • Identifikon personazhet në tekstin letrar • Përshkruan situata nga jeta e përditshme që i përshtaten veprimeve të personazheve nga tekstin letrar

Shembuj të aktiviteteve:

- Mësimdhënësi lexon shembuj të tregimit, të fabulës, të përrallës dhe të vjershës dhe ju sqaron nxënësve dallimin mes tyre. Pastaj nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër letrar nga letërsia për fëmijë (përmes leximit të mësimdhënësit ose përmes audio/video inçizimit), e pas kësaj, me grupe të vogla nxënësish bisedojnë për atë se çfarë kanë dëgjuar, tregim, fabul, përrallë ose vjershë.
- Mësimdhënësi paraqet një video me tregime popullore (të ketë kujdes që tregimi të mos përmbajë dhunë ose stereotipe gjinore, etnike). Nxënësit shiqojnë dhe pastaj bisedojnë për përmbajtjen e tregimit. Identifikojnë personazhet, i përshkruajnë ngjarjet sipas radhës dhe përcaktojnë vendin dhe kohën e ngjarjes.
- Mësimdhënësi lexon një përrallë ku nxënësit degjojnë me vëmendje dhe pastaj të ndarë në grupe bisedojnë për përmbajtjen, përshkruajnë personazhet dhe ngjarjet (cilët janë reale e cilët të imagjinuara).
- Mësimdhënësi lexon një tekst, ndërsa nxënësit përmes përgjigjes së pyetjeve përcaktojnë fillimin, pjesën kyesore dhe përfundimin e tekstit. Pastaj e ritregojnë atë sipas radhitjes së ngjarjeve (kronologjisë).
- Mësimdhënësi së pari lexon tekstin e një përralle, pastaj ritregon përmbajtjen. Në fund nxënësit dramatizojnë përrallën.
- Mësimdhënësi lexon një dramë të shkurtër njëaktëshe. Secili nxënës viaton një skenë nga drama njëaktëshe në të cilën ilustron dialogun mes dy personazheve (p.sh. si në stripa).
- Mësimdhënësi lexon një tekst të shkurtër letrar, ndërsa nxënësit symbyllur imagjinojnë personazhet. Pastaj i përshkruajnë dhe i vizatojnë sipas imagjinatës së tyre.
- Mësimdhënësi lexon një tekst të shkurtër letrar, më pas bisedon me nxënësit rreth kohës kur është zhvilluar ngjarja. Nxënësit identifikojnë fjalët që përcaktojnë kohën (natë, ditë, muaji maj, vit).
- Mësimdhënësi në mënyrë shprehëse lexon një vjershë me rimë. Pasi diskutojnë për përmbajtjes e saj, disa herë përsërisin pjesë-pjesë (mësimdhënësi sëbashku me nxënësit), me qëllim që nxënësit ta mbajnë mend dhe ta riprodhojnë në tërësi.
- Nxënësit krijojnë rima sipas analogjisë së vjershave të dëgjuara në klasë.
- Nxënësit me ndihmën e shkronjave të mësuara, numrave dhe vizatimeve përpilojnë një ftesë për ndonjë ngjarje.
- Mësimdhënësi lexon tre fjali si fillim të përshkrimit të një ngjarjeje ndërsa nxënësit përfundojnë përshkrimin e ngjarjes me fjalët e tyre.

- Mësimdhënësi lexon një tregim të shkurtër pa përfundim, ndërsa secili nxënës sajon një përfundim të tregimit.
- Nxënësit punojnë në çifte. Në tregim të shkurtër radhisin ngjarjet sipas një seri fotografishë dhe pastaj tregojnë nga një fjali për secilën prej tyre, duke përshkruar ngjarjen në fjalë.

Fusha programore: **SHKRIM-LEXIMI MEDIATIK DHE KULTURA E MEDIAS**

Orët totale:

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. nxjerr informacionin nga llojet e ndryshme të mediave me ndihmën e mësuesit;
2. kuptojë përmbajtjen e një shfaqjeje teatrale për fëmijë dhe/ose një shfaqjeje kukullash.

Përmbajtjet (dhe nocionet):

Standardet për vlerësim:

- **Informacione nga media të ndryshme**
(filma të animuar, shfaqje televizive dhe radio-emisione për fëmijë, revista për fëmijë)

- Nxjerr informacione nga tekstet e dëgjuar pas udhëzimeve të dhëna (tekst nga radio-emisionet, reklamat televizive/radio, filma të animuar)
- Nxjerr informacione nga tekstet e shkruara pas udhëzimeve të dhëna (nga broshurat, nga reklamat e gazetave/billboardeve, nga revistat për fëmijë, tekste nga interneti)

- **Ngjarje kulturore**
(shfaqje teatrale për fëmijë, shfaqje kukullash)

- Tregon përmbajtjen e shfaqjes sipas pyetjeve të dhëna.

Shembuj të aktiviteteve:

- Nxënësit dëgjojnë një tekst në radio-emision (ose reklamë televizive/radio, film të animuar) dhe veçojnë një ose më shumë informacione mbi pyetjet e paravendosura nga mësuesi (p.sh. Kur ka ndodhur diçka konkrete?, Si ishte koha?, etj)
- Nxënësit ndjekin emision edukativ për fëmijë (nga televizioni ose interneti) dhe në grupe bisedojnë se çka mësuuan nga emisioni. Pastaj prezantojnë para të tjerëve.
- Nxënësit shikojnë poster të një festivali për fëmijë, poster për ekspozitë me vizatime për fëmijë, reklamë, billboard, biletë të ndonjë shfaqjeje dhe pastaj bisedojnë për informacionet që vërejnë në to.
- Pas ndjekjes së shfaqjes teatrale ose shfaqjes së kukullave, nxënësit shprehin përvojën e tyre përmes vizatimit, fotografisë, përmes të kënduarit, të shprehurit, me anë të lëvizjeve, etj.
- Nxënësit ndjekin shfaqje teatrale ose shfaqje kukullash dhe pastas nëpërmjet luajtjes së roleve paraqesin pjesën që më shumë u ka pëlqyer.

INKLUZIVITETI, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI INTERKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron inkluzivitet përmes kyçjes së të gjithë nxënësve, në të gjitha aktivitetet që zhillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale përmes qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënës me aftësi të kufizuara, zbaton plan arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënës dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e ndjeshme, që të mundet në kohë t'i identifikojë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajoj dhe mbështes ata në arritjen e rezultateve të të nxënës.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë ashtu edhe vajzat duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipe gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, përipiqet të sigurojë një ekuilibër të bazuar gjinor. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, përdor ilustrime dhe shembuj sensacional gjinor dhe etnik/kulturor, që inkurajojnë barazinë gjinore, përkatësisht, të promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/nocioneve. Integrimi i'u mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndë të tjera mësimore, në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndrëlidhin njohuritë nga fusha të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ju mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi përcjell vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënës duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informata kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- punimet e nxënësve (krijime, rrëfime, etj.);
- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- përgjigjet e dhëna në fletët e punës;
- realizimet praktike (të lexuarit, të shkruarit)
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kuize (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;

Vlerësimi sumativ kryhet në bazë të të dhënave të përgjithshme të përfituara nga përcjellja e arritjeve të nxënësit dhe nga vlerësimi formativ, duke përdorur teknika të ndryshme të vlerësimit formativ, ku mësimdhënësi konstaton (përshkruan) shkallën e zhvillimit dhe të të arriturave për çdo nxënës veçmas, në kuadër të secilës fushë programore.

Fillimi i implementimit të programit mësimor	Viti 2021/2022
Institucioni/bartës i programit	Byroja e zhvillimit të arsimit Биро за развој на образованието
<p>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i arsimit dhe shkencës solli programin mësimor nga lënda e gjuhës shqipe për klasën I</p> <p>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик</i> за I одделение.</p>	<p>бр. 12-6200/13 9.4.2021 година</p> <p style="text-align: right;">Министерка за образование и наука, Мила Царовска, с.р.</p>